

MUZ 2024

e mërkurë | 12 Qershor | ora 18:30
tek Shtëpia me Gjethe, Tiranë

DJ Set
CRUDA

Performancë Arti Bashkëkohor Pamor
SUIDA DUSHI

Art Informal
PETRO THAKA

Portrete në Skulpturë
EDUART KARAJ

organizuar nga: mbështetur nga:

Ample



DJ Set **GRUDA**

Gruda is a house music DJ, one of the best in our town, who will create a storytelling set exclusively for Muz24.

Find him on Mixcloud as [gruda24](#).



Performancë Arti Bashkëkohor Pamor

SUIDA DUSHI

Një mbledhje midis personazheve jashtë kohës, por brenda historisë. Fragmentet dhe siluetat e kulturës antropologjike për të kujtuar rrugëtimin e një vendi që ndërthuret me kulturën intelektuale. Bashkëjetesa, njohja, dhe dialogu i kulturës me vetveten e drejtojnë këtë "krijesë" të njerëzimit për të nxjerrë në jetë një kulturë gjithmonë më të pasur dhe të denjë për të trashëguar. Përmes projeksioneve, por gjëja akoma më e rëndësishme, përmes vëzhgimit, do të hedhim pak dritë mbi natën e kulturës.



Art Informal

PETRO THAKA

Quhem PETRO THAKA
Bashkëshort i Irma Kuçit
Babai i Elea Thakës

Viti i Lindjes 1981 prill, Tiranë
Artist - (Arti Informal)

Përmendja e vitit të lindjes nuk është rastësi. Lidhet me punën time dhe zvjillimin e idesë që më shtyu në eksperimentimin dhe vazhdimësinë e artit tim. Në këto punime artistike (grafike), qëllimi është të sillja në kohë reale "Një Proces", që në memorien time është ngulitur që në fëmijëri, në kohën e komunizmit.

Memoria e rikthyer e "Një Procesi"

Rikthehem tek "Një Proces" përkujdesjeje ndaj gjërave, që si fëmijë, i kishim shumë të shtrenjta; Tek lojërat dhe koleksionimi i çdo gjëje që na dukej e veçantë: pullat, letrat e karamelëve, të çokollatave, çamçakëzave etj. Këtu më ngacmoi imazhi i ngelur në mendjen time i letrave të çokollatave edhe çamçakëzave që më binin në dorë, të cilat me kujdes të madh i ruaja në një libër të trashë si një koleksionist fanatik.

Të qenit afër një ndërtese si ish Ekspozita "Shqipëria Sot"

Nuk kam hyrë kurrë brenda ish ekspozitës "Shqipëria Sot" dhe nuk e kam as më të voglën ide se çfarë kishte atje brenda. Mbjaj mend i vogël, që aty vinin shume turistë me autobuzë të mëdhenj, jo të zakonshëm për kohën. Nuk e di se si mblihdeshim poshtë atyre autobuzëve, por kujtoj që kishim mësuar një fjalë: "KIZ". Funkciononte me turistet, të cilët na hidhnin ndonjë gjë nga dritaret e autobuzëve. Me duart e zgjatura drejt tyre, ne luftonim kush të kapte i pari ëmbëlsirën e hedhur. Kur arrija të merrja diçka, e shtrengoja fort në dorë "trofeun" dhe shkëputesha nga grupi me vrap. Unë ruaja çdo lloj ambalazhi ëmbëlsire që më binte në dorë, dhe kthehesha pa vetëdije në një koleksionist "trofeshë".

Rikthim tek "Procesi" dhe përkthimi në gjuhën e artit.

Jam munduar që "Procesin" e ruajtjes së ambalazhit "Trofe", ta risjell si "Proces Pune" në artin tim, duke futur edhe elementë të tjerë: forma gjeometrike (Origami), prerje dhe ngjyra të qarta në një format letre (Tabak). I udhëhequr nga fantazia dhe instikti i një "fëmije naiv", me ngjyrat, dritëhijet dhe format që krijohen në letër, unë sjell kujtesën në realitet, duke mbajtur përherë ngjyrën gri si balance, dhe si një urë bashkimi me ngjyrat ose në bardhezi.

Përherë ka vend për përmiresim ose zhvillim. Puna ime është në eksperiment të vazhdueshëm.

Hera herës përseritet si formë, por asnjëherë i njëjtë në perfundim. Ky "Proces" konsiston në ngritjen e një forme të caktuar deri në zhvillimin e saj, dhe më pas në kthimin e gjendjes fillestare të letrës (si material bazë i përdorur). Nganjëherë i lehtë si proces, e nganjëherë i lodshëm e plot pengesa.

Baza e përdorur për punën janë: Letra, Spray Paint, Prerëse, Laps, Vizore, Ngjitime, Kapëse, etj.



Portrete në Skulpturë

EDUART KARAJ




Portret malësori.

Simbolika është tek fisnikëria dhe burrëria e të parëve tanë.

Gjysherëve me mustaqet apo me hundën gati mitike, tregon urtësinë dhe besnikërinë e këtyre burrave.

E gdhendur në dru arre, e kompozuar edhe si një Portret Kontemporan.



Portret djali me plis metali

Si një thirrje për rikthimin e plisit si simbol i trashëgimisë kulturore.

E stilizuar në formë moderne edhe si një vepër me vlera estetike.